



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 747 Prot.

Tiranë, më: 27.01.2022

URDHËR

Nr. 38, Datë 27.01.2022

“PËR

**PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË APLIKIMIT PËR VENDOSJEN E STRUKTURËS
SË SHËRBIMIT NË BREZIN E SHËRBIMEVE TË STACIONIT TË PLAZHIT”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të gërmës “ç”, të pikës 7, të nenit 14 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar dhe pikës 1/1 të nenit 41, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Përcaktimin e mënyrës së aplikimit për vendosjen e strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit për subjektet e parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 7, të nenit 14, si më poshtë vijon:

a) Subjekti aplikon në portalin e-Albania për vendosjen e strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit, sipas përcaktimit të gërmës “ç”, të pikës 7, të nenit 14, të vendimit nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar, njëkohësisht, me kërkesën për menaxhimin e stacionit të plazhit.

b) Sipërfaqja e lejuar e strukturës së shërbimit mund të jetë deri në 10 (dhjetë) % të të gjithë sipërfaqes së miratuar të stacionit të plazhit, por, në çdo rast, nuk mund të tejkalojë sipërfaqen totale prej 60 (gjashtëdhjetë) m2.

c) Subjekti, kur bën kërkesën për menaxhimin e stacionit të plazhit, duhet të ngarkojë në momentin e aplikimit në portalin e-Albania edhe projektin arkitektonik, shoqëruar me relacionin përkatës, si dhe foto të zonës ku kërkohet të ndërtohet struktura e shërbimit.

ç) GTSHA-ja, kur konstaton se subjekti ka mungesë apo paqartësi dokumentacioni, njofton menjëherë subjektin për plotësimin e tij nëpërmjet portalit e-Albania.

d) Në rast se nga GTSHA-ja vlerësohet se subjekti plotëson kriteret dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikat 7 dhe 9 të nenit 14 të VKM-së 171/2019, të ndryshuar, subjekti njoftohet, nëpërmjet portalit e-Albania, që të aplikojë pranë KKT-së, nëpërmjet sistemit e-leje, për miratimin e lejes së ndërtimit për vendosjen e strukturës së shërbimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

dh) Subjekti, pasi merr vendimin me kusht të miratuar nga KKT-ja, bashkëpunon me Njësinë përkatëse të Vetëqeverisjes Vendore për të negociuar mbi sipërfaqen konkrete që merr në përdorim, brenda parcelës së miratuar për përdorim si stacion plazhi, përfshirë edhe brezin e shërbimeve, sipas rastit dhe ngarkon në sistem dokumentacionin shtesë, të përcaktuar në paragrafin “c.i”, “c.ii” dhe “c.ii/1”, të pikës 10, të nenit 14 të VKM nr. 171/2019.

e) Pas verifikimit të plotësimit të të gjithë kërkesave të përcaktuara më sipër, GTSHA-ja miraton aplikimin e subjektit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, nëpërmjet portalit e-Albania, dhe AKB-ja njofton menjëherë subjektin dhe NJVV për nënshkrimin e kontratës, sipas formatit tip, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1172, datë 24.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar.

ë) Para nënshkrimit të kontratës, subjekti duhet të paraqesë marrëveshjen e noterizuar me vrojtuesin e plazhit (shoqëruar me certifikatën përkatëse të kualifikimit), e vlefshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, si dhe Vendimin me kusht të KKT-së për miratimin e stacioneve të plazhit.

f) Në përfundim të nënshkrimit të kontratës, subjekti pajiset me certifikatën e përdorimit të stacionit të plazhit, e cila lëshohet nga ministri përgjegjës për turizmin.

g) Kontrata e nënshkruar ngarkohet nga subjekti në sistemin e-leje, si kusht për vijimin e procedurës për lëshimin e Dokumentit të Lejes së Ndërtimit, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2. Subjektet që kërkojnë lidhjen e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve ose që kanë nënshkruar kontratat për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve para miratimit të këtij Urdhri, sipas shkronjës “a”, “b” dhe “c”, të pikës 7, të nenit 14 të VKM-së 171/2019, në rast se kërkojnë vendosjen e strukturës së shërbimit, në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit, të përcaktuara sipas pikës 4, të nenit 9, të vendimit nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar, nuk ndjekin procedurën e përcaktuar në këtë urdhër. Këto subjekte aplikojnë direkt pranë KKT-së për miratimin e lejes së ndërtimit për vendosjen e strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit.

3. Ngarkohen GTSHA-ja, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

